

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-173/13

**Prishtinë,
23 prill 2014**

Në çështjen juridike të:

R.H

Pala ankuese

kundër

Z.C.T

Paraqitësja e kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112/2011 (lënda është regjistruar me numër KPA34038), të datës 29 shkurt 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 23 prill 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Lëndët GSK-KPA-A-173/13, GSK-KPA-A-174/13 dhe GSK-KPA-A-175/2013 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruara me numrin GSK-KPA-A-173/13.
- 2- Pranohet ankesa e R.H kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112/2011, (lëndët e regjistruar në AKP me numrat KPA34037 dhe KPA34039), të datës 22 qershor 2011 dhe KPCC/D/A/112/2011, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA34038) të datës 29 shkurt 2012.
- 3- Modifikohen vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112/2011, (lëndët e regjistruar në AKP me numrat KPA34037 dhe KPA34039), i datës 22 qershor 2011 dhe KPCC/D/A/112/2011, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA34038) i datës 29 shkurt 2012, dhe refuzohen kërkesat e Z.C.T të regjistruara si KPA34037, KPA34038 dhe KPA34039.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 23 mars 2007 dhe 10 tetor 2006, Z.C.T ka paraqitur kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar vërtetimin e së drejtës së saj pronësore mbi tri ngastra dhe reposedimin e tyre, që të gjitha me lokacion në tokat e fshatit Drobesh, në Viti. Sipas planit kadastral ngastrat kanë këta numra: 202, 236 dhe 238. Paraqitësja e kërkesës ka shpjeguar se pronën e ka humbur për shkak të rrethanave që kanë ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998/1999 dhe se data e humbjes së pronës ishte 12 qershor 1999. Ajo ka paraqitur dokumente të ndryshme në mbështetje të kërkesave të saj. Të gjitha dokumentet janë verifikuar nga ekipi verifikues i AKP-së.
2. Njoftimi fizik i kërkesave është bërë në vitin 2007. Më vonë u kuptua se shenjat e njoftimit janë vendosur në vendet e gabueshme dhe përsëri është bërë njoftimi i pronave, por kësaj radhe përmes publikimit në Gazetën Zyrtare të AKP-së – në gusht 2010.
3. Kërkesat janë trajtuar si të pakontestueshme.
4. Për më tepër, KKPK-ja ka pranuar kërkesat si të bazuara dhe ka marrë vendimet e kundërshtuara, *d.m.th* KPCC/D/A/112/2011 (lëndët e regjistruara me numër KPA34037,

- dhe KPA34039), të datës 22 qershor 2011 dhe KPCC/D/A/140/2012 (lënda e regjistruar me numër KPA34038) të datës 29 shkurt 2012.
5. KKPK-ja ka pranuar se paraqitësja e kërkesës është pronare e ¼ së pronave. Vendimi i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës më 28 shkurt 2012.
 6. Më 28 qershor 2013, R.H ka paraqitur ankesa kundër vendimeve me pretendimin se ato janë marrë në mungesë të provave dhe duke shkelur të drejtën material.
 7. Ai ka paraqitur një kontratë për shitblerje të pronave të njëjta, e datës 28 nëntor 2011. Në të njëjtën ditë nënshkrimet e palëve janë vërtetuar në Gjykatën Komunale në Viti. Kontrata është lidhur në mes të palës ankuese si blerës në njërin anë dhe paraqitësja e kërkesës si dhe anëtarëve të tjerë të familjes së saj në anën tjetër (Z.C.T, I.R, S.P dhe G.M – ata ishin bashkë-pronarë me të drejta të barabarta në pjesë ideale).
 8. Më 10 tetor 2013, paraqitësja e kërkesës tani pala përgjegjëse në ankesë Z.C.T ka paraqitur një përgjigje në ankesë ku ka deklaruar se nuk ekziston asnjë bazë ligjore për ankesë, sepse pronat tashmë i janë shitur palës ankuese. Ajo pretendon se e ka paraqitur një kërkesës për mbylljen e rasteve dhe se nuk ekziston asnjë arsye për këto procedura ankimore.
 9. Gjykata e interpreton përgjigjen si një kërkesë për heqje dorë nga kërkesat.

Arsyetim ligjor:

Bashkimi i lëndëve

10. Gjykata i referohet nenit 408.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin në vijim LPK), i zbatueshëm *mutatis mutandis* (kur kërkohet) në procedurën para Gjykatës Supreme (neni 12.2 i Ligjit nr. 03/L-079). Ai iu ofron mundësi gjykatave të bashkojnë procedura nëse një bashkim i tillë kontribuon në efikasitetin e atyre procedurave.
11. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme gjen se tërë bazat faktike dhe ligjore, si dhe çështjet rreth provave, janë krejtësisht të ngjashme në këto tre raste. Vetëm ngastrat që janë objekt i së drejtës pronësore, që janë kërkuar në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në të njëjtën deklaratë dhe në të njëjtat dokumente. Për më tepër, arsyetimi ligjor i dhënë nga Komisioni është i njëjtë për të gjithë.

12. Lëndët e regjistruar me numrat GSK-KPA-A-173/13, GSK-KPA-A-174/13 dhe GSK-KPA-A-175/13 bashkohen në një lëndë të vetme të regjistruara sipas numrit GSK-KPA-A-173/13.

Pranueshmëria e ankesës:

13. Pala ankuese nuk ka qenë e njoftuar siç duhet lidhur me procedurën në AKP, por ai nuk është parandaluar nga e drejta e tij për t'u ankuar.
14. Neni 10.2 i Ligjit nr. 03/L-079 parashikon që çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës, është palë në këtë procedurë, me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë Ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën.
15. Ligji në nenin 10.1 *po aty*, parashikon që Sekretariati do të “bëjë përpjekje të arsyeshme ta njoftojë çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor mbi pronën”. Ai nuk parasheh ndonjë përshkrim specifik se çfarë “përpjekje të arsyeshme” nënkupton me përfundimin se “në rastet e caktuar një përpjekje e arsyeshme mund ta merr formën e shpalljes në një publik zyrtar”. Interpretimi gramatikor i tekstit nxjerr në pah përfundimin se publikimi është një përjashtim më shumë se sa një rregull dhe që vet rregulli duhet hiqet në bazë të logjikës së zakonshme dhe zakoneve ekzistuese.
16. Deri më tani është e pranueshme se sipas rregullit, njoftimi është bërë me vendosjen e shenjës (tabelës) për njoftim lidhur me kërkesën në 3 gjuhë (anglisht, shqip dhe serbisht) në/mbi pronën në pyetje dhe përderisa është vendosur shenja në/mbi vendin/objektin-gastrën, shtëpinë etj., të duhur, njoftimi konsiderohet i bërë siç duhet dhe palët me interes të mundshëm të jenë njoftuar me kohë rreth procedurës para AKP-së, përveç nëse ka arsye për të besuar ndryshe.
17. Në rastin konkret nuk është kontestues fakti se në vitin 2007, shenjat e njoftimit nuk janë vendosur në vendin e duhur. Më vonë, në vitin 2010 është bërë një njoftim i ri, por përmes publikimit.
18. Prandaj, pala ankuese nuk mund të konsiderohet të jetë njoftuar me rregull dhe se nuk e ka humbur të drejtën të marrë pjesë në procedurë, *d.m.th.* ankesa është e pranueshme.

Heqja dorë nga kërkesat:

19. Paraqitja e kërkesës Z.C.T ka hequr dorë nga kërkesat e saj (heqja dorë është shprehur në mënyrë të qartë në përgjigjen ndaj ankesës).
20. Gjykata i referohet nenit 149.1 të LPK-së.
21. Dispozita thotë se nëse para shqyrtim gjyqësor (e cila nuk është relevante në procedurat aktuale të ankesës) paraqitësja e kërkesës heq dorë nga kërkesa, gjykata do ta refuzojë kërkesën. Ndryshe nga heqja dorë e një kërkesë, e rregulluar me nenin 261.1 të LPK-së, heqja dorë nga kërkesa nuk ka nevojë për pëlqimin e palës tjetër, pavarësisht se kur ndodh. Prandaj, gjykata nuk ka nevojë ta diskutojë këtë heqje dorë me palën ankuese.
22. Në kontekstin e procedurës para Kolegjit të Apelit të AKP-së, kjo nënkupton se gjykata duhet ta pranojë ankesën dhe t'i modifikojë vendimet e kundërshtuara, duke refuzuar kërkesat.
23. Në bazë të të lartcekurave dhe në lidhje me nenin 13.3 (a) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 12.2, *po aty*, lidhur me nenin 149.1 të LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv.

24. **Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it